



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1733/2 Prot.

Tiranë, më 18.09 2026

V E N D I M
Nr. 244 dt. 18.09 2026

PËR

**SHPLLJEN E KONKURSIONIT PËR 2 (DY) PUNONJËS, PERSONEL AKADEMIK
AS/LEKTOR ME KOHË TË PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË
FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT PRANË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FFVR me nr. 1733/1 prot., datë 15.09.2026, "Për hapjen e konkursit për punësimin e 2 (dy) punonjësve personel akademik (As/Lektor) me kohë të pjesshme në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit, FFVR" Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in <http://www.ust.edu.al> të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI AKTIVITETIT FIZIK, REKREACIONIT DHE TURIZMIT

2 (dy) As/Lektor

- Lënda: "Disiplina Sportive II"
- Moduli: Danc-Folk

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Asistent Lektor" për Lëndën "Disiplina Sportive II", Modulet: "Danc-Folk" në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit, janë si më poshtë:

II. KRITERE TE PËRGJITHSHME

II	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. -Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pikë në vlerësim, gjithsej 10 pikë. -Përfshihen nga kërkesa vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet praktika mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
3	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht). Përfshihen nga kërkesa e pikës 5, vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
4	Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në përcaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
5	Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

Kritere specifike:

1. Të ketë Diplomë Bachelor dhe Master (3+2) në Programin e studimit Koreografi.
2. Të ketë përvojë në fushën e kërcimit folklorik dhe njohuri të thelluara teorike në fushën Koreografike.
3. Të ketë aftësi në komunikim dhe bashkëpunim.
4. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
5. Të ketë kryer aktivitet shkencor si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
6. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës.

Kritere preferenciale:

1. Preferohen kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e Danc Folkut dhe Koreografisë.

III. Kandidatët që do të aplikojnë për këtë vënd pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit në **rruge elektronike ne web-site te UST-se dhe ne menyre postare:**
- Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Njësia Kryesore, Njësia bazë, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

V. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare ose të gjithë paketën me dokumenta e dërgon elektronikisht në web-site të UST .

- VI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VII. Deri në datën 28.09.2026, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 30.09.2026 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë pune.
- VIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

- IX.** Dekanati i FVFR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 02.10.2026, për miratim në Rektorat.
- X.** Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XI.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KAS

